



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË TRETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 31.03.2022 (e Enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, kryetari, z.Sokol Haliti, nënkryetari, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Ekrem Ymeri, Arbnore Hajredini, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Zejnepe Osmani, Ali Bajrami, Jakup Demiri, Liridona Bislimi, Sejdi Emini, Nexhat Halili, Majlinda Shabani, Remzi Salihu, Durim Sylejmani, Lindita Demelezi, Musli Neziri, Vilsona Maliqi-Salihu, Zyrafete Rama, Anisë Zejnullahu, Reshat Azizi, ndërsa mungoj Taibe Ibrahimimi, Taulan Haxhiu, Veton Ramadani. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit.

Pasi u konstatua se prezent janë 24 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e tretë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! duke pas parasysh nga seancat e kaluara kemi miratu disa vendime, ju njoftoj që Zyra Ligjore e MAPL-së na i ka konfirmu ligjshmërinë e të gjithë vendimeve, ju lus ju të cilët nuk e keni bërë deklarin e pasurisë ta bëni sepse sot është afati i fundit për deklarin të pasurisë. Tani kalojmë tek pyetjet jashtë rendit të ditës.

znj.Majlinda Shabani: Përshëndetje për të gjithë të pranishëm! Para se me fillu takimi, kryesuesi tha: “të nderuar media”. E unë sot nuk po shoh media. Po shpresoj që ky problem të zgjidhet shpejtë, sepse është forma më e mirë për transparencë sa i përket pikave të rendit të ditës. Jashtë rendit të ditës. Kam disa si shqetësim lidhur me gjendjen e WC-ve në Shkollën fillore "Dëshmorët e Vitisë". Papastërti, gjithashtu rrezik nga rënia e tavanit të objektit. Mbeturinat pothuajse në secilën lagje - sasi e gjeneruar e tyre, e që paraqet ndotje të ambientit e rrezik të shëndetit tek qytetarët. Të ofrohet zgjidhje përmes bashkëpunimit dhe shtimit të kapaciteteve me kompaninë publike-private “Eco Higjiena”. Ne e dimë që shpeshherë arsyetimi nga ana e komunës është që nuk është kompetencë e komunës, mirëpo ne besoj që mujmë me ofru një bashkëpunim, që mu shtu këto kapacitete. Ndriçimi publik mungesë në disa pjesë të fshatit Lubishtë, Buzovik, Drobesh. Premtimet po thuaja se gati tetëvjeçare. Shpyllëzimi i pyjeve në sasi të madhe. Vetëm në muajin mars nga autoriteti pyjor në këtë komunë në koordinim me policinë janë konfiskuar 14 metra dru, që u janë zënë prerësve ilegal në terren në katër automjete me të cilat po transportoheshin. Kërkesë për angazhim më të madh të komunës në mbrojtje të pyjeve nga keqpërdoruesit. Zyra e pensionistëve të komunës, e cila është në mungesë të zyrtarit të punës. Pse nuk është bërë hapja e konkursit për plotësimin e saj? Kjo zyrë në bazë të informacioneve punon 2-3 ditë në javë, gjë e cila paraqet vështirësi në përmbushjen e shërbimeve të kërkuara. Kthimi i gjendjes së mëparshme të kupëzave të

betonit në rrugën "Agim Ramadani" në Viti (nga kompania kontraktuese për vendosjen e gypave të ujësjellësit në këtë rrugë, pas mbarimit të punës nuk është kthyer gjendja e mëparshme të tyre).

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Kur e përmenda mediat, i kemi prezent këtu edhe Plusin edhe Shyqeri Halabakun, po nuk kemi transmetim direkt, sepse mediat janë prezent. Zyra e Prokurimit janë tu e përgatit tenderin për këtë.

z.Ali Bajrami: Kryesues, faleminderit për fjalën e dhënë, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë kam dy pyetje për drejtoreshën së arsimit rreth zgjidhjes së përfundimit të shkollës në Pozharan, se e dimë sa u zgjatë kjo. Pyetjen e dytë e kam për drejtorin e bujqësisë rreth subvencioneve që do të fillojnë të ndahen për bujqit e vyeshëm të Komunës së Vitisë.

z.Iliri Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam më shumë pyetje, po për hir të rregullores po I bëj vetëm dy pyetje. Nënkyetar, në vitin 2014 kemi nxjerr një rregullore për mirëmbajtjen e varrezave në Komunën e Vitisë: a është mëndu ndonjëherë të ndahet buxhet për këtë, që të mirëmbahen ato varreza. Për drejtoreshën e arsimit e kame bë para nja dy seancave një kërkesë me intervenu në çerdhen ne Qifllak. Para dy dite një fëmijë është rrëzu dhe ka pesu lëndime. E din gjendje si është në çement dhe tepision. Kërkoj sa me shpejt të intervenohet të shtrohet një gum aty, sepse është rrezik aty. Dhe e fundit, në fshatin Ramjan, tek ura aty, mbrojtje e urës mungojnë aty, nxënësit që shkojnë në shkollë ish shumë rrezik. Është kërkesë e banorëve që të rregullohen aty.

znj.Lindita Demelezi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam disa pyetje. Pyetja e parë ka të bëjë me obligimet e komunës ndaj pronareve të parcelave të marra nga komuna për shtrimin e rrugës "Sherif Frangu", Viti-Sllatinë, financuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Komuna e Vitisë. Komuna përmes përfaqësuesit, Zyra e Kryetarit, pra kryetari dhe nënkryetarit, kane premtuar që do të bëjë kompensimin dhe rregullimin e parcelave për ata që e kanë lëshuar për hapjen e rrugës. Çfarë hapa keni ndërmarrë për të filluar kompensimin dhe rregullimin e pozitive të parcelave? Meqenëse të gjitha ato janë toka bujqësore: a do të kompensohen edhe për pjesën e subvencioneve? Të cilat nuk do të mund të i marrin apo edhe mbjellin për shkakun se ju nuk i keni kryer procedurat siç keni premtuar dhe ofruar një dokument për nënshkrim. Me këtë kërkoj nga ju të i kryeni sa më shpejt obligimet që fermerët të mund të i mbjellin dhe të i marrin subvencionet dhe kompenzimin për sipërfaqen e tyre sepse siq duket për komunën mund të rriten obligimet nëse nuk kryhen me kohë. Pyetja e dytë është rreth kërkesës për të rregulluar ujërat e zeza që rrjedhin përmes fshatit Sllatinë e Poshtme. Këshilli i Fshatit të Sllatinës së Poshtme ka bërë kërkesë me datë 17 shtator 2020, për të bërë zgjidhje për filtrimin e ujërave të zeza, të cilat vijnë nga fshatrat Ramjan dhe Novosellë përmes lumit, ku pësojnë shtëpitë që janë rreth rrugës "Pranvera Shqiptare", nga papastërtitë dhe kundërmimi. A keni marrë ndonjë hap për të zgjidhur dhe përgjigjur në këtë kërkesë. Këto kërkesa do t'i bëjë edhe me shkrim dhe përgjigjet kërkoj që të kthehen me shkrim.

znj.Zyrafete Rama: Të nderuar të pranishëm! Komuna e Vitisë po përballet me mungesë të ujit të pijshëm dhe cilësi të dyshimtë të ujit në disa lokalitete. A ka Komuna e Vitisë një projekt konkret me afat të caktuar kohor për shtimin e kapaciteteve dhe rritjen e cilësisë së ujit të pijshëm në këto lokalitete? Një pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë. Ambulanca e fshatit Zhiti është jofunksionale: ka një planë konkret Drejtoria e Shëndetësisë për funksionalizimin e saj.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Dua ta ngris çështjen e administratorëve të fshatrave. Mendoj që komuna duhet ta gjej një formë dhe ta bëj një pagesë për ta, për panënë që e bënë, sepse kjo do t'i stimuloj pak a shumë dhe me një far forme do t'i shpërblen për punën e tyre. Në mandatin e kalum, disa komuna fqinje i kanë bë pagesën. Dua të diskutojmë rreth problemeve të taksistëve këtu tek sheshi. Ne e dimë që gjate seancës së kaluar është thënë që, ky problem është zgjidhur dhe është ofruar një dokument, mirëpo unë sot mbajtja një takim me taksista dhe ai dokument nuk po ju kryen punë, taksistët vazhdojnë të marrin gjoba

nga policët tonë kërkoj që ekzekutivi të gjen një zgjidhje reale siç duhet, për shkak se ky problem është duke na përcjellë tash e 2 vite. Dhe një tjetër mendim që kam tash, edhe 2 ditë kemi me hyrë në muajin e shenjtë të Ramazanit, komuna duhet të gjejë disa forma që të shpërndaj pako familjare për 100 - 150 familje me asistencë sociale. Kjo do t'i ndihmonte familjet me gjendje të tillë. Komuna ka mjete, ka forma që t'i ndihmojmë këto familje me nevojë.

z.Musli Neziri: Përshëndetje kryesues dhe gjithë ju të pranishëm! Pyetja jem e parë është për drejtoreshën e arsimit, konkretisht është pyetja për çerdhen në Viti, pasqyrat financiare. E kem pas një krahasim në vitin 2021, kem pas një rritje prej 206% të hyrave në çerdhe. Pyetja është: sa është rrit numri në çerdhe, sa është kapaciteti i çerdhes që nuk i përmbush kërkesat, po nuk e mbingarkojmë numrin e çerdhes për arsyeje që fëmijët duhet të kenë kujdes, edukatorët kanë vështirësi, por a duhet të rritet numri të ketë dallim kaq të madh brenda 2 viteve. Çështja tjetër është në rrugën “Rexhep Bislimi”, duke filluar prej ambulantes, një pjesë e shtëpive ose lagjeve nuk kanë kyçje në kanalizim. A ka ndonjë projekt që kanë parapa mu shtri kanalizimi në atë pjesë që të vazhdohet prej “Lindi-it” për Kllokot, që është zone industriale, aty ka biznese të ndryshme që kontribuojnë në tatime ndaj komunës janë taksapagues të Komunës së Vitisë. Ju mungon edhe infrastrukturë, kanalizim, ujësjellës, trotuar dhe ndriçim. Çdo ditë shohim punëtorë që lëvizin në këmbë dhe janë të rrezikuar, sepse janë punëtorë të qendrave tregtare ose bizneseve të ndryshme. A do të parashihet që të bëhet një infrastrukturë ose një investim në rrugën “Rexhep Bislimi” deri në zonë kadastrale që është deri me Komune të Kllokotit.

z.Reshat Azizi: Përshëndetje kryesues! Shqetësimin e banorëve të Kabashit të rrugës “Rrustem Kabashi”, ndriçim publik nuk ka, trotuar, ujësjellës jo. Çështja tjetër në rrugën në drejtim të restorant “Arena” është gjendja me mbeturina. Pyetjen tjetër e kam prej lokalitetit të Stubllës së Epërme: deri ku ka mrri çështja e ujësjellësit është fillu, është ndërpre dhe nuk punohet aty. Pyetja e tretë: kemi pas komitetin për komunitet, kemi has në problem, se s’kemi pas përkthyes të gjuhës. Ka mundur me dështu seanca, se s’ka përkthyes komuna.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje për të gjithë! Kam dy pyetje. Pyetja e parë është për drejtoreshën e arsimit, pyetja e dytë është për drejtorin e shërbimeve publike. Drejtoreshë, a ka mësimdhënës të pranuar vitin e kaluar me kontratë të caktuar, të cilët vazhdojnë të punojnë edhe këtë vit pa shpallur konkurs për persona të tjerë? Dhe pyetja e dytë për drejtorin e shërbimeve publike. Me 21 mars filloi Dita e Pranverës, rrugët e Vitisë atë ditë janë pastruar me ujë: çfarë ka ndodhur sipas informatave që kam dëgju, po flitet se 8 apo 11 aksidente? Çka keni bërë ju si drejtori për ta adresuar këtë shqetësim të personave të cilët janë aksidentu? A keni kontakt me kompaninë e cila e mbanë mirëmbajtjen.

z.Basri Sylejmani: Përshëndetje kryesues! Kam dy tri pyetje në çështjen me fshatin Sadovinë e Muhaxherve, është lagjja “Shkodra” që i lidhë me Tërstenik dhe për ujësjellësin që është e lidhtë, Tërsteniki, Sadovina e Muhaxherve, Sadovina e Jerlive. Ju kisha lutë sa më shpejtë me ndërmarr se të reshurat atmosferike nuk ka dhe çështja e ujit Sadovinë të Jerlive. Kam dhe një pyetje me bërlllokun është çështja se duhet me intervenu secili në fshatin e vetë. Vetëm në fshatin tim paguajmë 110 shtëpi. Janë 240 shtëpi, 130 shtëpi hedhin bërlllok. Me i shti njerëzit në regjistër inspekcioni jonë që është nivel të kuvendit dhe me zgjidhë çështjen e bërlllokut.

z.Nexhat Halili: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Së pari kam një kërkesë, kemi kërku prej drejtorit të financave të naj sjell në kuvend obligimet ndaj komunës. Kërkesa ka qenë, zotimet të cilat janë bërë gjatë vitit 2021 të cilat nuk janë paguar. Pyetja e parë për ujin e pijshëm për 5 fshatra, nuk po shoh që është marr një hap këtë drejtim. Pyetja e dytë ka të bëjë me kontratat për punë të cilat po lidhen 2-3 vite, kontratat të cilat janë lidh në vitin 2020-2021. Ato kanë nga dy vite kur është lidh kontrata, është lidh me çmimet që ne i dimë që kohën e mëhershme kanë qenë çmimet ma të ulta. Tash çmimet kanë ndryshu. Dhe një pikë të derivatet e naftës. Çfarë hapa ka marr komuna në këtë drejtim. Mund ndodhe që operatorët ekonomik nuk mujn të realizojnë këto kontrata të cilat i kane lidhë.

znj.Arbnora Hajredini: Përshëndetje nënkryetar, drejtor, këshilltar! Kam një pyetje rreth fletëpagesave të tatimit në pronë. Pse nuk shpërndahen nëpër shtëpi po lihen në rrugë nga 20 fletë të grumbullime. Du me ditë arsyen pse.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për kryesuesin, nënkryetarin, drejtorët, kolegët. Unë kam një njoftim dhe një pyetje. Te njoftimi është ndriçimi publik. A e keni diskutu me kompaninë, mirëmbajtësit, ndriçimi publik dhezet, pa nevojë shpenzimi i energjisë. Edhe në Smirë është i njëjti problem, thuajse për dy muaj ditë. Kam vërejtur këto ditë në disa lokalitete dhe të tjerët se shumë herët po dhezen dritat. Dhe pyetja te drejtori i inspektionit për shkak se kemi shumë vende që grumbullohen mbeturinat dhe a kanë ndërmarr si drejtori për t'i larguar ato mbeturina. Të njëjtën kohë: a ka shqiptu naj gjobë për naj qytetar të pandershëm në hedhjen e mbeturinave, pothuajse në asnjë fshat nuk mungojnë këto.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje të pranishëm! Unë sot do të ngris një kërkesë e cila është në interes të qytetarëve të Komunës së Vitisë, Viti ka nevojë për një stacion meteorologjik, siç dihet komuna jonë shtrihet rreth maleve të Karadakut, rrjedhimisht ka klimë të ndryshme me komuna tjera. Këtë e vërejnë më së miri ata të cilët rrugëtojnë Viti-Prishtinë. Siç dihet kushtet klimatike luajnë një rol edhe në kultivimin e kulturave bujqësore, e që ndoshta është edhe burimi kryesor i cili është në interes të qytetarëve të komunës tonë. Në mungesë të një stacioni meteorologjik në Viti, ne gjithmonë i referohemi të dhënave të motit nga Ferizaji dhe Prishtina. Mendoj se është me interes që komuna jonë ta kërkojë një stacion meteorologjik dhe ta jetësojë këtë, se dihet në kohërat më të hershme prodhimet bujqësore të banorëve të Vitisë janë mbrojt nga fatkeqësitë natyrore. Në kohërat e mëhershme janë shpernda mjegullat me breshër duke i marr statistika dhe janë mbrojt kulturat bujqësore të fermerëve. Dhe një kërkesë për rrugën Viti-Binçë, shëtitorja që është ajo pjesë është bërë mjaft e frokuentume me qytetarët të cilët dalin të ecin. Mendoj që gjatë stinës së verës qytetarët rrezikohen nga gjarpërinjtë. Duhet të spërkatet me medikamente që të zhduken ato, që gjatë stinës së verës qytetarët të cilët dalin ecin aty në shëtitore mos të jenë në rrezik nga kafshimi gjarpërinjve, sepse janë të përhapur për shkak se lumi, uji është aty, mund të rrezikohen.

z.Naim Pira, drejtor i bujqësisë: Përshëndes kryesuesin e kuvendit, nënkryetarin dhe të gjithë të pranishmit. U parashtrun 2-3 pyetje sa i përket sektorit të bujqësisë. Njëra nga këto ishte nga këshilltarja Majlinda Shabani, rreth shkatërrimit të pyjeve. Po është e vërtet. Jo vetëm këtë vit po në vazhdimësi jo vetëm nga mbas lufta pyjet në Komunën e Vitisë pothuajse krejt Kosovën janë shkatërruar në masë të madhe. Natyrisht me marrjen e pozitës së drejtorit të bujqësisë, jem tu bërë përpjekje maksimale, që me një mënyrë t'i vendosim një rend dhe është një aktivitet i shtuar. Gjatë këtyre dy muajve të fundit janë konfiskuar mbi 14 metra kub dru, i kem ngjeshura aktivitetet dhe me policinë, dhe kërkoj mbështetjen e juve si këshilltar komunal që ne te jem me një nivel detyrës, të kem një bashkëpunim që t'i ruajmë pyjet, sepse me një formë ata janë pasuria e të gjithë neve. Pyetja tjetër e cila u adresua nga z.Ali Bajrami, ishte rreth subvencioneve. A është e paraparë nga Komuna Vitisë, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, të jepen subvencionet këtë vit. Nëse ke pyetja për nivelin lokal, jemi në procedura, është bërë thirrja, mundeni me pa edhe në vebfaqen e komunës, do të jenë rreth dhjetë parcela me gjysmë hektari, që do të jepen për herë të parë në Komunën e Vitisë. Një thirrje tjetër ka qenë edhe për subvencionimin e bujqve për 400 hektar me farë misri, por sipas gjitha gjasave si duket do të dështoj. Kemi ankesa nga ana e operatorëve dhe ju e dini që afati optimal për mbjelljen e kulturës së misrit është diku nga 10 deri me 25. Nëse vonohen këto procedura, unë jam i mendimit që ta anuloj nëse nuk arrij me kohë me siguri farën e misrit. Një pyetje tjetër sa i përket subvencioneve të nivelit qendror. Them se nuk e kem asnjë informatë. Natyrisht bujqit çdo ditë vijnë në zyrat tona dhe pyesin për formën, modelin, po nuk kem informatë shtesë se si do të rrjedhin subvencionet dhe cila do të jete forma e aplikimit për subvencionet e nivelit qendror. Po shpresoj brenda kësaj periudhe dot na informojnë përmes email ose ndonjë formë tjetër, dhe ne do të jemi te

gatshëm në vazhdimësi t'i informojmë edhe bujqit e komunës tone. Dhe pyetja tjetër e cila me të drejtë nga ana e këshilltarit, z.Sejdi Emini rreth një stacionit meteorologjik kishte qenë e mirëseardhur, apo ato format tjera të cilat shërbehen. Na do të bëjmë përpjekje të bisedojmë për këtë çështje dhe është në interesin e qytetarëve që të kemi një gjë të tillë.

znj.Fatbardha Emini, drejtoreshë e arsimit: U parashtruan disa pyetje që e përfshinë fushën e arsimit, disa janë kompetencë e jona disa nuk janë. Te shkolla e Pozheranit, është sfidë për Komunën e Vitisë, për shkak se investitorët janë Qeveria e Kosovës. Ka qenë Ministria e Administratës Publike, tani është kompetente Ministria e Punëve të Brendshme. Një prej takimeve që ju kam drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, sekretares dhe menaxherit të kontratës, takim të cilin e kemi zhvillu së bashku me operatorin dhe me kryetarin e komunës edhe me 3-4 shkresa tjera. Në javën e kalume ka qenë edhe menaxheri i kontratës. Kemi marr një zotim dhe se korriku ka me qenë ku ka mu dorëzu shkolla. Çka është e rëndësishme se mjetet buxhetore janë për shkollat, po janë neglizhencë të operatori ekonomik që nuk po arrin me përfundim ,po ju njoftoj për korrektësi ne i shqyrtum edhe mundësitë tjera me procedurë gjyqësore, Ministria e Punëve të Brendshme, sekretaria ja ka dhënë operatorit një afat shtesë në korrik me letra është me zotim, që në afat të korrikut të bëhet dorëzimi dhe përfundimi i shkollës fillore “Halil Alidema”, pastaj palestra janë tu zhvillu procedurë tjetër dhe rrënimi i shkollës së vjetër mundeni me pa edhe përmes prokurimit publik, që nuk ja ka dhënë operatorit vetëm për arsye mund zvarritet shkolla, nuk po arsyetoj as akuzoj askënd. S’ka me pas më arsyeshmëri vonesa e shkollës së Pozheranit. E kem këtë zotim. Atë ditë mbikëqyrja para shkollës dhe para menaxhmentit të shkollës, që Korriku është afati i fundit që ja kanë dhanë me dorëzu objektin e shkollës. Sa i përket financave në kodin buxhetor, të gjitha janë sa i përket ndërtimit të shkollës. Tek dysHEMEJA e çerdhes në Qifllak, e kem bisedu me Ilirin, se nuk ka laminat, vetëm iberçuk dhe tepison. Ne kemi përfundim procedurat për planifikim, ekzaminim të shkollave, është këqyrë edhe dysHEMEJA. Nuk kemi pas mundësi tjetër për me vepru menjëherë. Çerdhja e fëmijëve, e ngriti Muslia, është një prej çështjeve që prioritet për mu janë dhe çerdhet. Në seancën e parë kemi shku në caktim të lokacionit për ndërtimin e çerdhes së re ne Viti. Vitia ka nevojë për kapacitete ma shumë të çerdheve. Kërkesat janë jashtëzakonisht të mdhaja të prindërve për me i dërgu fëmijët në çerdhe. Kam shku, e kam parë gjendjen, kapacitetet janë për 70 fëmije, dikun janë 100 fëmijë që shkojnë në çerdhe. Secili grup e ka edhe një edukatore më shumë, për shkak të kujdesit të fëmijëve, që ashtu ka edhe fëmijë që kanë nevoja me rekomandim të specialisteve të fushës, që kanë nevojë përkatëse. Ju i keni shqyrtu në seancën e kalume pasqyrat financiare 2021 dhe sigurt është për shkak të numrit më të madh të fëmijëve në çerdhe dhe të hyrat janë me të mdhaja. Janë procedurë e prokurimit të ndërtimit e një çerdhes nga ana e ministrisë, atëherë rriten kapacitetet dhe nuk do të ketë mbingarkesë. Ka me shqyrtu mundësinë me i largu, por nuk është në rregull, sepse ata kanë kontratë prej 1 Shtatorit dhe çdo largim i fëmijëve është shkelje e marrëveshjes që e kanë institucioni parashkollor. Është rritë numri i edukatorëve për kujdesin për kohë të caktume, për shkak numrit më të madh të fëmijëve aty. Profesori e ngriti një çështje të kontratave më kohë të caktume. Shifer të saktë nuk muj me të dhanë, se graviton nga muaji në muaj, se ka profesor që zëvendësojnë pushimet e lehonisë, ka që i zëvendësojnë pushimet mjekësore ka dhe profesor që zëvendësojnë edhe të zgjedhur si menagjera të shkollave si drejtor. Ka profesorë që zëvendësojnë lendet që nuk janë adekuat dhe janë me kohë të caktume dhe nga çdo vit shqyrtohet mundësia e vazhdimit apo mosvazhdimit të këtyre kontratave.

znj.Merrushe Ahmeti, drejtoreshë e shëndetësisë: Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket çështjes për ambulanten e Zhitisë, ambullanta e Zhitisë është renovu siç ka qenë e paraparë, ndërsa për vitin 2022 është e planifikuar që me u bë renovimi edhe i kopshtit. Ambullanta e Zhitisë është e gatshme me fillu punën, mirëpo për shkak situatës pandemike dhe të fokusit të madh të njerëzve, kanë qenë kryesisht në QKMF, atëherë është vendos, mirëpo me një të ardhme të afërme ka mu bë.

z.Adnan Imeri, drejtor i inspektionit: Përshëndetje për të gjithë! Asambleti Jakup Demiri e parashtroj një pyetje për shqiptimin e gjobave për rastin që po hedhin mbeturina. Inspektorët e ambientit dhe inspektorët e shërbimeve publike, gjatë kësaj kohe kanë qenë jashtëzakonisht aktiv për vende publike. Është vështirësi për me arrit me nxon dhe pastaj të njëjtit i regjistrojmë në “Ekohigjien”, që mos të hedhin mbeturina vend e pa vend. Po ashtu i detyrojmë që t’i largojmë shembull atë vend ta kthejmë në gjendjen e mëparshme, duke i detyruar që ato mbeturina të hedhin në kontejner publik që i kem. Vlejmë të cekim, gjithashtu do t’i kem edhe ditët e ambientit nga data 1 Prill deri me 22 Prill, që fshatrat të gjithë të pastrohen dhe deponitë ilegale të largohen. Është me rëndësi po e bej një thirrje publike për punonjësit shtetëror dhe kompanive publike. Ata të cilit marrin pagë prej shtetit, i kisha udhëzua të shikojnë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave të regjistrojnë “Ekohigjien”, për arsye se personi i cili hedh mbeturina, fjala është e bënë demin, nëse ai hyn në sistem të menaxhimit mbeturinave.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: I nderuar kryesues i kuvendit komunal, qeveritar, këshilltar të kuvendit komunal, zyrat e kryetarit, mediat e shkruara dhe elektronike. Po konsideroj se gradualisht po ja japim konturat e kuvendit komunal. Është për mu përgëzua për respektim të rregullores. Pyetjet të cilat u shtruan, të cilat i kam përgjigjet. Dy çështjet të cilat brengosin edhe për juve dhe për neve, është çështja deponive ilegale dhe çështja prerjes ilegale të pyllit. Jem tu e bë maksimumin, derisa jem tu bë dhe një plan të cilin e tha dhe drejtori i inspektionit për këto 22 ditë të jem shumë aktiv. Të hynë në lëvizje tërë mekanizmi institucional, edhe qytetarët e Komunës së Vitisë të na ndihmojnë këtë drejtim, që me të vërtet të zgjojmë edhe ndërgjegjen edhe atyre të cilët në mënyrë ilegale hedhin mbeturina vend e pa vend, të cilët e shëmtoj edhe natyrën, po edhe vet jetën naj bëjnë më të vështirë. Gypat e ujës jellësit në rrugën “Agim Ramadani”. Unë besoj që do ta shiqoj çështjen e kontratës, e nuk ka kontratë e cila nuk është pasuesi që ai duhet me kthi në gjendje si ka qenë, do ta shiqoj këtë. Një rregullore që ka qenë e miratime në vitin 2014, që i ka pas mirëmbajtjen e varrezave në të gjitha nuk kemi muj me realizu, sepse ka kërkua shumë investime, po në të ardhëm besoj që kemi me insistu për këtë, për obligimet e komunës, për kompozimin e pronave në Sllatinë. Unë kam pas takim edhe vitin e kaluar që i përgëzoj të gjitha ata qytetarë të Sllatinë të cilët kanë shpreh gatishmëri me i leshu pronën falas, kanë qenë dy raste që e kanë kerku kompensimin, po ka qenë periudhë që kemi hy në fushatë zgjedhore e nuk kemi pas të drejtë. Me Këshillin e Fshatit Sllatinë e kanë bë një marrëveshje që janë zotu që me te vërtet atyre dy personave me ju kompensu kam bisedu me drejtoreshën e katastrofit, e besoj që do të rregullohet kjo çështje. Nuk e kemi lan në harresë, do të rregullohet edhe kjo. Ujërat e zeza të fshatit Ramjan e Navosellë. Unë e di që në mandatin e parë kur kemi ardh e kemi bë një shpronësim atje pronës 22 ari, e ku është një gropë, për momentin e kane parapa ata ekspert që e filtron ujin, e tash sa ajo gropë nuk është në funksion nuk e di, do t’i pyes drejtorët e të marr informacione me të sakta. Mungesa e ujit të pijshëm e rritja e cilësisë, e ngriti një prej këshilltarëve. Është e vërtet që ne po ballafaqohemi me këtë problem, e ku edhe sot e kemi rend dite, zgjerimi për vendin e fabrikës për rritjen e kapacitetit. Duhet ta shpronësoj një tok aty, e për këtë çështje e kualitet, se a është ujë i pijshëm a po jo kujdeset enti higjienik, ata e kontrolloj a është ujë i pijshëm. Liridona për pagesën e kryetarëve të fshatrave, na përcjellë kjo breng. Nuk mundet Komuna e Vitisë me e rregullu në aspekt individual, nuk ka takim që nuk e kam ngrit këtë çështje. Tek çështja e parkingut, besoj që kanë taksistët dokument prej komunës, nuk ka polic që i dënon, përndryshe, nëse e kanë dënu, ka qenë mu lajmëru tek unë, e kishim bisedu me komandantit. Tek pakot familjare nuk isha ndal, sepse ju e dini që muaji i Ramazani është muaj i rahmetit, e ka njerëz të mirë që japin ndihma. Për rrugën “Rexhep Bislimi”, e kemi pas si problematik, e konsideroj që së shpejti do t’i bëhet zgjidhja edhe aty, se e di që janë pa kanalizim. Nuk po bëhen krejt përnjëherë, çështje e përkthyesit, besoj që shpejt do ta rregullojmë. Sadovina për qat lagje që u cek, nuk po e di a është e parapa këtë vit ndriçimi aty, ndërsa tek ujës jellësi prej kuvendit nja tri takime që e kam pas e kam rrit maksimalisht, po ujë nuk po del në parametrat e ujit të pijshëm. Çështja e zotimit, drejtorin e financave sot e kame qu unë në Prishtinë për çështje të ujit, me e

dërgu një letër rreth ekzekutimit të disa mjeteve. Çështja e kontratave dyvjeçare, po unë besoj që komuna nuk mundet me bë kurgja në këtë drejtim, sepse ju e dini që komuna e ka buxhetin e aprovum, besoj që është problem mbinaçional që i kalon kufijtë shtetëror, se kjo luftë e cila ka ndodh me ngritjen e këtyre çmimeve enorm. Unë besoj që Qeveria e Republikës së Kosovës është tu bë diçka në drejtim të kësaj, e me ato kontratat të cilat janë të nënshkruara me gjet një përqindje që me bë një zgjidhje, sepse operatorët ekonomik që i kanë kontratat e nënshkruara, po e ndalin punën, sepse kërkush nuk investon pa fitim. Tek çështja e faturave, ne kemi kontratë me PTK-në, do ta shikoj këtë problematik që e ngrite ti këshilltarë. Edhe çështjen e dritave do t'i shiqoj që të dhezen në kohën e duhur e jo gjatë ditës.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Tek çështja e menaxhimit të mbeturinave. Edhe vitin e kaluar e kemi miratu një rregullore edhe planin e veprimi që është me pak se gjysma e popullatës e përfshimë në menaxhimin e mbeturinave e që është problem shqetësues. Ne duhet të bëjmë presion që të jenë të gjithë në menaxhimin e mbeturinave. E kam pas një kërkesë nga “Eko Higjena”, që të rriten tarifat e çmimit, e unë nuk e kam prurë në kuvend, sepse nuk e kam pa të arsyeshme.

z.Illir Zuka: Unë e pata një pyetje për drejtoreshën e arsimit, po ajo nuk është tani këtu po e la për mbledhjen e radhës. Nënkyetar thave që, “Hidro Morava” nuk e bënë kyqjen e pesë fshatrave për arsye se ka sasi të mangamit edhe nuk e merr përgjegjësinë për mi lidh. A është e njëjta rrjedh e ujit që me ju tregu qytetarëve të Pozharanit, që ky ujë ma nuk është i pijshëm, edhe para dy tri seancave e kame kërkun këtë. Para dy jave mirëmbajtësi i sheshit në Pozharan ka ndërru jetë, ju kisha lut nga institucionet që ta dërgoni një mirëmbajtës, sepse sheshi po kthehet ne deponi e bërllokut.

z. Ramadan Deliu: Nënkyetar ju ftoj që në Kabash me i qu inspektorët, e ke keshyr kush po e hudh mbeturinat aty.

znj.Liridona Bislimi: Nënkyetar, tek çështja për pagesën e administratorit siç e ceka, ekzistojnë disa komuna që e ndajnë një shumë simbolike për administratorët e fshatrave, një nder ta me sa kam dëgju unë është Komuna e Gjilanit. Kishte qenë mirë me pa komunat tjera si e kanë praktiku ata me bë edhe ne në komunën tonë. Tek pakot familjare, është e vërtet që gjatë këtij muaji kemi persona që ndihmojnë në këtë aspekt, mirëpo çështja e çmimeve ka lujt rolin e vet, që familjet me asistencë sociale e kanë më të vështir këtë vit, e besoj si komune duhet me ju ndihmu. Tek problemi i parkingut të taksistëve, unë sapo e pata një takim, ata dje pasdite kishin marr dënim me gjobë e ku që dy vite po flasim për këtë problemin e taksistëve. Ju lus sot që ta merrni këtë punë me seriozitet.

z.Basri Sylejmani: Për taksistet kam fol disa here, ata nuk i dënojnë ku janë parkingjet, ama duhet me pas shenjen aty edhe vendimin që është vend për taksistë aty, a nëse i zë ne zebra i dënojnë.

znj.Majlinda Shabani: Sa i përket menaxhimit të mbeturinave, unë pajtohem me folësit paraparak, mendoj që na mungon vetëdijesimi si qytetar që e kemi, po paraparakisht duhet të shtyhen qytetarët që ta bëjnë pagesën për mbeturina, mirëpo duhet të shtohet edhe kapaciteti i kompanisë për mbledhjen e mbeturinave.

z.Nexhat Haliti: Kërkoj obligimet e komunës që i ka dhe obligimet që janë ndaj komunës të specifikuar, m'i sjell në seancën e ardhshme drejtor.

z.Musli Neziri: Tek rruga “Rexhep Bislimi”, nënkryetari nuk dha ndonjë afat apo angazhim me konkret të realizimit të saj, kështu që kërkoj që të merret me trajtu me seriozisht aty.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Ilir, unë po e thamë me sinqeritetin më të madh, çështjen e manganit kanë me e rregullu edhe me ngritjen e atyre pompave uji i Pozharanit kontrollon. Drejtoresha më ka thanë që është i pijshëm e duhet me i besu. Dhe çështja tjetër, do t'i marrim edhe praktikën e komunave tjera për pagesën e administratorëve. Nexhat, përgjigjet do ti merr nga drejtori besoj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për këtë seancë kemi parapara këtë rend dite:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja a dytë e rregullt e KK-së.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Shërbime Publike.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Planifikim, Rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen e mjedisit.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në konsultim publik draft ndryshim plotësimin e statutit të komunës së Vitisë me Nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale me nr. 00002-3 në zonën kadastrale në Letnicë.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Kabash.
8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2022
9. Informatë (raport) për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën Janar – Dhjetor 2021.

A ka dikush rreth rendit të ditës? Pasi që nuk ka për diskutim: kush është që të punojmë me këtë rend dite, me ngritje dore. Me 24 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim, u miratu.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja a dytë e rregullt e KK-së

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Hap debat rreth procesverbalit. A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

z.Remzi Salihu: Në faqen nr. 6, këtu është si diskutim i imi, po ky nuk është diskutim i imi, është ngaterru me dikan tjetër. Kërkoj që të përmirësohet.

z.Musli Neziri: Faleminderit kryesues. Në faqen nr. 3 të fjalimi im, këtu është një gabim gjuhësor, ku thuhet është gri a duhet me qen është ngrit çështja e ujit, andaj kërkoj që të përmirësohet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka të tjera vërejtje, me këtë vërejtje e hedh në votim procesverbalin. Me 23 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim u miratu.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Kryesuesi z.Bekim Azizi; Me këto tri komitet që i kemi në këtë mbledhje, i përfshimë të gjithë anëtarët e kuvendit, që të jen pjesë e të gjitha komiteteve. Nga LDK-ja kemi marr këtë propozime: Valentina Mehmeti e Sokol Shaqiri; nga LVV-ja: Nexhat Haliti; dhe nga PDK-ja Taulant Haxhiu. A ka dikush për me diskutu. Me 23 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim, u miratu.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Shërbime Publike

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Nga LDK-ja kemi marr këta propozime: Basri Sylejmani, Taibe Ibrahimimi; nga LVV-ja: Sejdi Emini; edhe dy përfaqësues do t'i përfshimi nga pjesa e jashtë kuvendit. A ka dikush për me diskutu. Me 23 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim u miratu rendit i ditës.

Si pike të katërt kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Planifikim, Rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen e mjedisit

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Nga LDK-ja kemi marr këta propozime: Ekrem Ymeri; nga LVV-ja: Durim Sylejmani dhe Remzi Salihu; nga PDK-ja, Anis Zejnullahu dhe një nga shoqëria civile. A ka dikush për me diskutu. Me 24 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim, u miratu.

Si pikë të pestë kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në konsultim publik draft ndryshim plotësimin e statutit të komunës së Vitisë me Nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011

z.Fatlum Demiri, kryetari i komisionit për ndryshim plotësim të statutit: Faleminderit kryesues, përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në seancën e kaluar kuvendi ka miratuar vendimin për emërimin e komisionit për ndryshim plotësim të statutit të Komunës së Vitisë. Komisioni është taku dhe në këtë rast mua me ka zgjedhur kryesues të këtij komisioni. Ne si komision kemi dal me disa rekomandime, mirëpo këto nuk do me thanë që janë rekomandime përfundimtare. Ne sot para juve kërkojmë që të miratohet propozim vendimi për konsultim publik të ndryshim plotësim të statutit. Bazuar në udhëzimet administrative konsultimi publike do të zgjat 30 ditë. Pas këtyre dite do të organizojmë debat publik me datën 06.05.2022 në këtë sallë dhe ju ftoj e kërkoj që të kontribuoni në këtë ndryshim plotësim të statutit. Materialin e keni marr me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Mendoj që pjesë e statutit duhet të jetë edhe Komiteti për Bujqësi dhe çështja e logos, po megjithatë hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Illir Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kame kërku prej Fatlumis që, të ju dorëzohet komplet statuti këshilltarëve, për shkak se duhet me pa ne. Unë mendoj që duhet me bë ndryshime edhe ne logo, sepse e kemi këtu në logo edhe Komunën e Klllokotit.

z.Remzi Salihu: Tek neni 10, e kam këtu një vërejtje, ku thuhet se i shtohet një shkronjë L me emërtim Sektori për punën e Kuvendit Komunal të Vitisë. Tash sipas logjikes, kjo e duhet të jetë i, dhe duhet te jetë Sektori për Punë i Kuvendit.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! E falënderojmë Fatlumin për këtë punë që kanë bë, do të jemi pro dëgjimit publik dhe do të kontribuojmë gjate konsultimeve publike, edhe në diskutim final që ta nxjerrim një statut funksional.

z.Nexhat Halili: Unë kame një pyetje: nëse është në procedurë Ligji për Vetëqeverisje Lokale për ndryshim, pse ne tash po ngutmi pak, duhet ta presim deri sa të bëhet Ligji për Vetëqeverisje Lokale e tani t'i bëjmë ndryshim plotësimet, sepse munde ndodhe që të naj imponoj prapë.

z.Fatlum Demiri, kryetari i komisionit për ndryshim plotësim të statutit: Faleminderit për pyetjet Ilir. Sa i përket logos, e kemi diskutu ne komision, mirëpo statuti bazë thotë që, logo duhet të ndryshohet me vendim të veçantë. Kjo nënkupton që, duhet të themelohet një komision tjetër me ekspert të fushës dhe të bëhet ndryshim plotësimi i logos. Kjo është arsyja pse nuk e kemi propozu tani. Remzi, në statutin bazë janë të renditura sektorët në bazë të shkronjës, e tani me renditje vjen shkronja L, e duhet me pas për bazë udhëzimin administrativ të MAPL-së, e komunat tjera, të cilat komuna e kanë të themeluar Sektorin për Punë të Kuvendit. Ndoshta ka gabime drejtshkrimore. Sa i përket Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, është e vërtet që ka kalu në lexim të parë, unë jam interesu, kame pyet deputet, ish koleget e mi në Administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Bazë informacioneve që i kam nga ata, janë një grumbull i ligjeve që presin për miratim. Bazë këtyre

informacioneve na merr kohë bukur shumë pas miratimit të Ligjit, duhet me shku tek presidentja, me dal ne gazetën zyrtare, e tani MAPL ja duhet m'i nxjerr aktet nënligjore e me fillu së zbatuari. Unë e shoh të arsyeshme që tani të bëjmë ndryshim plotësimin e statutit.

z.Reshat Azizi: Faleminderit Fatlum për sqarimin. Po qysh bëhet harmonizimi pastaj i statutit komunal me MAPL-në. Unë po i shof do sene shume të ndjeshme, këtu sidomos tek thirrja e seancës inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga kryetari (aty ku është zgjedhur) e me posh thotë, nëse kryetari nuk e thirr e thirr anëtari me i vjetër, e nëse na ndodh ndonjë problem, duhet me kërkua interpretim, e siç e kemi pas rastin tani ne, e ku MAPL ka thanë që mbledhjen inauguruese e thirr kryetari i komunës në bashkëpunim me kryesuesin.

z.Fatlum Demiri, kryetari i komisionit për ndryshim plotësim të statutit: Reshat, në statutin bazë, neni 28.2, aty thuhet: që mbledhjen inauguruese e thërret kryesuesi paraprak, që gjë është në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe udhëzimet administrative. Pika tjetër thotë: nëse kryesuesi nuk e thirr, e thërret me i moshuari.

z.Nexhat Halili: Unë propozoj se, nëse nuk i thërret me i moshuari le ta thërret me i riu.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Tek neni 28, paragrafi 28.2 të statutit qe thuhet: mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga kryetari (aty ku është zgjedhur), pika me kryesore që ka qenë në njërin nder mbledhjet e komisionit në MAPL ka qenë kjo, edhe tash është tu përgatit një strategji tjetër për dhënien e betimi të këshilltarëve dhe seancën inauguruese. Tek pika tjetër, te neni 13, paragrafi 13.3, kandidatët për pozita të anëtarëve të këshillit lokal apo kryetarëve të këshillave lokal nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur/emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve/partive politike, kjo tingëllon mirë po se di a funksionon për këto. Do të kontribuojmë edhe në dëgjim publik. Po edhe unë jam që mos të ngutmi, sepse ka me pas ndryshime në Ligjin e ri për Vetëqeverisje Lokale.

z.Sokol Hyseni: Përshëndetje të nderuar të pranishëm nuk pajtohem me propozimin që seancën ta thirr më i riu.

z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës: Pas miratimit të ndryshim plotësim të statutit, ne duhet të dërgojmë në MAPL për konfirmim të ligjshmërisë. Prapë MAPL-ja e jep vlerësimin.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, qes në votim për miratim që të shkon në diskutim publik. Me 23 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim u miratu rendit i ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale me nr. 00002-3 në zonën kadastrale në Letnicë

znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Bëhet fjalë për një projekt për zgjerimin e rezervarit të ujit në Letnicë, pronën që është afër prona private duhet me shpall zonë me interes e tani për shpronësim në seancën tjetër.

z.Jakup Demiri: Nënkyetari i ceku me herët që, nuk është gjetë pronari i kësaj parcele e nuk e di unë si muj me e procedu tutje pa e pas një deklaram të ati pronari të parcelës. Kërkoj një sqarim këtu.

z.Ali Bajrami: Pasi që është në pyetje interesi i përgjithshëm për ujë në e mbështesim këtë propozim vendim dhe do të votojmë pro.

z.Nexhat Halili: E kam një pyetje për drejtoreshën: a e ka studiuar gjendje faktike, a është tokë bujqësore apo çka është?

z.Musli Neziri: Drejtoresha tha, që do ta bënë shpronësimin qeveria. Unë po e pyes: cila qeveri lokale apo qendrore?

z.Reshat Azizi: Këtu në propozim po thuhet që vetëm zona me interes e kerkun nuk po përmendet shpronësimi, ka qen mire te ceket edhe shpronësimi.

znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë: Ky propozim është paraprak shpallet vetëm zonë me interes. Pa u shpallë zonë me interes nuk mund të bëhet shpronësim e prapë do të vjen në kuvend për shpronësim.

z.Sokol Haliti kryetar i komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Po përgjigjem në disa pyetje. Tek ky propozim vendim është interesi i përbashkët për rritjen e kapacitetit të ujit, mundësi operacionale teknike nuk kemi pa u zgjeru me hapësirë publike, e këtë hapësirë nuk e kemi, e kemi private e po duhet me shpronësu, vendimet i merr kuvendi e pagesën e bën ministria. Ne nuk jemi me e dëmtu palën. I kemi disa mundësi të mira për rritjen e kapacitetit, dikun 20 deri 40 litra në sekond muj me rrit. Me rendësi ne si kuvend me qenë në rregull. Tek ndryshim plotësim i statutit të komunës, nuk kalon pa hi në shqyrtim tek ministria, jemi që mos ta shkëlmi rregullaritetin ligjor. Sa i përket llogos së komunës, kjo duhet mu trajnu në mënyrë të veçantë. Është pak senzitive. Këtu ju lus mos u ngutni, sepse duhet me pas respekt pak edhe politik, sepse i di disa çështje që mujnë me ardh më vonë kur të kalojnë në rishqyrtim komunal, që kanë shku në decentralizim, e prandaj mos mu ngut këtu me logo. Tek toka pyjore e toka bujqësore, ajo ka qenë sigurish që me letra të vjetra kur ka qenë në kuadër të ekonomisë pyjore e me vonë është shndërru në tokë bujqësore, po në të ardhëm do të shndërrohet edhe ne tok ndërtime.

z.Nexhat Halili: Në Sadovinë i kemi dy ngastra në seancën e kalume. Njëra është tok pyjore, është dhënë në shfrytëzim, në realitet tokë bujqësore, e gjendja faktike shihet.

z.Sokol Haliti, kryetar i komunës: Kjo tokë ka qenë zabel me herët edhe është udhëheq me dokumente, po transformimi është bë. Ajo bëhet transferim real praktik.

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, qes në votim për miratim propozim vendimin për shpalljen interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale me nr. 00002-3, në zonën kadastrale në Letnicë. Me 23 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim u miratu.

Si pikë të shtat të rendit të ditës e kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Kabash

znj. Majlinda Ostergllava drejtoresh: Me kërkesën e fshatit Kabash, të cilët kërkojnë zgjerimin e varrezave që të vendosen rrethojat, konstatojmë që gjithçka është në rregull.

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Hapi diskutim për këtë pikë.

znj.Majlinda Shabani: Ekziston një rregullore për varrezat e i cila i parasheh disa kriteret, si neni 7 ku thuhet: që varrezat duhet të vendosen me një vend me sipërfaqe të mjaftuara të përshtatshme me kushtet e lokacionit për varrosje vendit i varrezave duhet të jete jashtë vendbanimit ose afër në qasje ne rrugë dy kakshe dhe me shtegun e ndarë për këmbësor. Hapësira për varreza duhet ti përmbush këto kriteret sipas pozitës. Toka e varrezave duhet të jetë e kulluar me rreze dhe jashtë ujërave të mbrojtur dhe zonave të tjera. Varrezat e reja duhet të jen se paku 50 metra nga rruga automobilistike, e te zgjerimi i varrezave ekzistuese duhet të kemi parasysh piken 3 të neni 7, mund të jen deri në 10 metra, me kusht që përgjatë varrezave të sigurohet një shirit gjelbërues me gjerësi minimale prej 5 metrave. Tu e marr parasysh nga vendi i propozuar më lart ne bazë të rregullores shohim që nuk i përmbush këto kriteret që e cekta, unë kame dal në teren e kame pa vendin. Hapësira në mes të rrugës është dikun 1 metër. Gjithashtu nuk ka tretuar, rruga është rrugë e frekuentuar nga banoret e asaj lagje, sidomos nga fëmijët e që paraqet rrezik për jetën e tyre, pasi që nuk ka tretuar. Fillimisht mendoj që është dash mu marr pëlqimi i qytetarëve, e sidomos të atyre që jetoj aty, e te cilët kane pas pakënaqësi. Mendoj që ka qenë dashur t'i behet një analizë më e mirë këtij propozim vendimi.

z.Musli Neziri: Këtu kemi të bëjmë me interesin e fshatit Kabash, e aty kanë qenë më herët varrezat. Duhet të jemi pragmatik, duhet të jemi konkret dhe të flasim real. Këtu e kemi këshilltarin nga Kabashi e ku kërkesa ka ardh nga Këshilli i Fshatit Kabash. Unë jam pro këtij.

z.Jakup Demiri: Unë në KPF kam qen pro këtij, po i kam pas disa takime me disa qytetar të fshatit Kabash, e ata nuk janë të pajtimi me këtë, po aty varrezat janë ekzistuese, e pjesa që ju shtohet mendoj që duhet mu bë me ndryshe, për shkak se po nxihet hapësira aty e nuk po ka vend as për trotuare. Çështja e kanalizimi. Ne si grup parlamentar në këtë pikë abstenojmë.

z.Sokol Haliti kryetari i komunës: Ky është një propozim i ndjeshëm e nuk kam dëshirë me u nda këtu, po kam dëshirë të jemi bashkë. A e dini pse? Më së pari vendndodhja e varrezave atje është e dislokume, janë varrezat e qytetit të Vitisë, janë ngjit atje, e ajo rregullore që e lexoj më herët, që unë e kam lexu shumë më herët, ato janë çështje që i takon magjistrates. Edhe çështja e pengesave që po thu ti, e aty disa kanë ra shumë më vonë se që janë varrezat e Kabashit. D.m.th varrezat janë shumë më të vjetra aty. Hajde e bëjmë një komision, dalim i shikojmë krejt varrezat me ren, po jo vet e vet me dal e me i kundërshtu. Ne kemi edhe kërkesa të tjera nga fshatrat tjerë.

znj.Majlinda Shabani: Unë e lexova rregulloren, po siç po thua ti kryetar, që e ke lexu, po zbatueshmëria e kësaj rregullore është zero. Unë i kam pyet qytetarët që janë afër me shpija aty. Ata janë kundër kësaj. Nuk jemi kundër zgjerimit, po thash mu be edhe një rishikim i vendit.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunës: Këshilltare, çështja e infrastrukturës, në këtë drejtim jemi tu punu ne e do të jenë transparent këto. Nëse ki ti një propozim për varreza në Kabash, urdhëro jepe propozimin.

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Jemi tu diskutu për një temë të ndjeshme. Është mirë ku ka hapësira për varreza të zgjerohen në krejt komunën. Unë nuk kisha diskutu për votat se si do të votoni ju.

z.Ali Bajrami: Ne si këshilltar të kuvendit duhet me marr vendim në favor të qytetarëve dhe që hinë në shërbim të qytetarëve. Kërkesa është e Këshillit të Fshatit Kabash, ju ka drejtu drejtorisë, drejtorja ka pru tek ne propozim vendim. Ne si grup jemi pro këtij propozim vendimi.

z.Hasan Aliu nenkryetar: Këshilli i fshatit e ka konsultu lagjet aty edhe e ka pru kërkesën edhe nuk kemi të bëjmë me varreza të reja që të respektohet ajo rregullore, është fjala për zgjerim të varrezave. Unë konsideroj që nuk kemi arsye tjetër që mos ta votojmë këtë propozim vendim.

z.Illir Zuka: Atë çka dashta me thanë e tha nënkryetari. Ne duhet me respektu kërkesën e këshillit të fshatit, sepse ne atë këshill janë të përfshira të gjitha lagjet, e kërkesa është bë në emër të të gjithëve aty.

z.Nexhat Halili: Nënkryetar, në seancën e kalume e kenë bë një propozim, e kemi votu propozimin, po me duhet dallimi ndërmjet ati të seancës së kalume dhe të këtij propozimi.

z. Jakup Demiri: Unë e kame pa tash u bë rrethoja e re e varrezave të kabashit dhe e shoh që është vetëm për sy se është shume afër rrugës a po e dimi që po i mbyllim për këmbësorët, edhe po me vjen mirë që kane fillu me u respektu kërkesat e këshillit të fshatrave.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunës: Në Kabash sa kështu si po thu ti ka hapësirë aty mundemi me shku tash me keshyr.

z.Ramadan Deliu: Aty kërkohet vetëm zgjerimi i vendit edhe nuk e pengon askën aty, ai vend është kërkesë e këshilli të fshatit. Ju lus që të miratohet ky propozim vendim.

z.Musli Neziri: Te njëjtin problem e kemi pas edhe me fshatin Ballancë, edhe e di rendësin e kësaj e nuk ka nevojë që një këshilltar i një fshatit me naj imponu si të veprohet me një fshat. Kërkoj që të hedhet në votim.

znj.Majlinda Shabani: Në fakt që është këshilli i fshatit edhe vendime merr në bazë të atyre. Unë po flas vetëm për banorë që çdo ditë e kaloj atë rrugë edhe i kanë shpreh shqetësimin tek ne.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunës: Duhet të jemi të gjithë pro në këto çështje, sepse janë të ndjeshme.

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, qes në votim për miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Kabash. Me 16 vota pro, 0 kundër, 8 abstenim u miratu.

Si pikë të tetë të rendit të ditës e kemi:

8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2022

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Materialin e keni marr, një plan të cilin e ka dorëzu komiteti për komunitete. Nëse ka për diskutim, hapi debat, nëse jo qes në votim për miratim. Me 24 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim u miratu.

Si pikë të nëntë të rendit të ditës e kemi:

9. Informatë (raport) për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën Janar – Dhjetor 2021

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Faleminderit kryesues! Për shkak të respektimit të këshilltarëve dhe legjislacionit para juve, e keni informatën për punën e KKSB-së. Materialin e keni marr me kohë, për pyetjet shitesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ju faleminderit për kontributin e dhënë në këtë seancë, shihem në mbledhjet tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:40 min.

Procesmbajtësi:

Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:

Bekim Azizi
